

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E ISTOGUT**

Për aktivitetin e prokurimit:

Nr. i Prokurimit ¹	633-25-7095-5-1-1
Nr i brendshëm	633-025-050-511

Sa i përket tenderit për: **“NDERTIMI I SHTEPISE SE KULTURES DHE PARKUT NE VRELLE -projekt 3vjeqar(633-025-050-511)”**.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NIL ARCHITECTS SH.P.K. & HIDRO PROJECT SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Lotë Vaku, nr 23

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

044-347-835

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Shkelzen Ademaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nilarch2018@gmail.com

(Adresa elektronike)

10.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënskrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë:04.08.2025
Hapja e ofertave: 15.09.2025
Njoftimi mbi vendimin e AK-së:28.07.2026
Kërkesa për rishqyrtim:03.08.2026
Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 05.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me dt.28.07.2026 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë OE NNP CTA SH.P.K., ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin si në vijim:

- Kapaciteti teknik dhe profesional – Kërkesa 1 - Pika 1.6.) Një (1) bachelor ose Master I mbrojtjes së ambientit-, me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Operatorit në fjalë I mungon Inxhinieri i mbrojtjes të ambientit, në vend të tij e ka emëruar një inxhinier të arkitekturës i cili nuk është kërkuar në këtë pikë 1.6.
- Kërkesa nr. 5, Operatori në fjalë nuk e ka të nënshkruar dhe as të vëlosur marrëveshjen për huazim të mjeteve me Kompaninë "Loni SH.P.K", po ashtu në përpilim të marrëveshjes data është e shënuar me 12.10.2025 gjë që e bënë të pavlefshëm marrëveshjen.

Arsyet e AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit janë të paqëndrueshme për faktet si në vijim:

- Sa i përket arsyes së parë të eliminimit, ku ne jemi eliminuar me arsyetimin se: *"Operatorit në fjalë i mungon Inxhinieri i Mbrojtjes së Ambientit, në vend të tij e ka emëruar një inxhinier të arkitekturës i cili nuk është kërkuar në pikën 1.6."*, sqarojmë se ky arsyetim është i pabazuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar në ofertën tonë.

Në ofertë, për këtë pozitë është prezantuar z. Arbër Berisha, i cili, përveç profesionit të tij si inxhinier i arkitekturës, posedon edhe licencë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), e lëshuar nga autoriteti kompetent. Pikërisht kjo licencë dëshmon se i njëjti është i autorizuar dhe i kualifikuar për ushtrimin e veprimtarive në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Rrjedhimisht, licenca për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) e bën z. Arbër Berisha profesionist të kualifikuar në fushën e mbrojtjes së ambientit dhe përmbush qëllimin e kërkesës së dosjes së tenderit për angazhimin e një eksperti të kësaj fushe. Prandaj, AK-ja nuk ka pasur bazë ligjore dhe faktike të konstatojë se oferta jonë nuk e plotëson këtë kërkesë vetëm për faktin se personi i propozuar ka profesionin bazë inxhinier i arkitekturës.

Prandaj, personi i propozuar nga ne posedon kualifikim profesional dhe autorizim në fushën për të cilën është kërkuar eksperti, ndërsa AK-ja nuk ka dhënë asnjë arsyetim se përse kjo licencë nuk është konsideruar e mjaftueshme për përmbushjen e qëllimit të kërkesës.

Në këtë rast mund të vie në shprehje neni 59.4 pika (ii) devijimet e vogla e të cilat nuk shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

- Lidhur me arsyen e dytë të eliminimit, ku jemi eliminuar me arsyetimin se: *"Operatori në fjalë nuk e ka të nënshkruar dhe as të vulosur marrëveshjen për huazim të mjeteve me kompaninë 'Loni' SH.P.K., po ashtu në përpilim të marrëveshjes data është e shënuar me 12.10.2025, gjë që e bën të pavlefshme marrëveshjen"*, sqarojmë se në rastin konkret bëhet fjalë për një lëshim teknik gjatë ngarkimit të dokumentacionit në platformën elektronike, ku gabimisht është bashkëngjitur një version tjetër i marrëveshjes.

Ne posedojmë marrëveshjen e rregullt, të nënshkruar dhe të vulosur nga të dyja palët, e cila ka ekzistuar në momentin e dorëzimit të ofertës dhe i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Për rrjedhojë, ky lëshim nuk ndryshon përmbajtjen substanciale të ofertës, nuk ndikon në aftësinë e tonë për realizimin e kontratës dhe duhet të konsiderohet si devijim i vogël, në kuptim të nenit 59.4 të LPP-së.

Për më tepër, nëse AK-ja ka pasur paqartësi lidhur me dokumentin e ngarkuar, ka qenë i obliguar që, në përputhje me nenin 59.2 dhe nenin 72 të LPP-së, të kërkojë sqarime apo plotësim të dokumentacionit, në vend që të na eliminojë menjëherë. Mos shfrytëzimi i këtij mekanizmi procedural ka rezultuar në një eliminim jo proporcional dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së.

➤ Ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe pasi që na është lejuar qasja në dokumente dhe pas analizës që i kemi bërë ofertës, kemi ardh në përfundim që i njëjti OE është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Fillimisht sqarojmë se kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë:

"Kapital financiar të mjaftueshëm për realizimin e kontratës në vlerë 150,000.00 euro duke specifikuar titullin e projektit dhe nr. e prokurimit për aktivitetin në fjalë ose qasje në kredi të pakushtëzuar, nga një bankë duke emërtuar projektin për të cilin lejohet kredia."

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur, pasi konfirmimi bankar i dorëzuar nga banka BPB nuk e specifikon titullin e projektit dhe numrin e prokurimit për aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Në konfirmimin e lëshuar nga banka, vetëm vërtetohet gjendja e mjeteve në llogarinë bankare të operatorit ekonomik, ndërsa në asnjë pjesë të dokumentit nuk identifikohet projekti për të cilin është lëshuar konfirmimi, as nuk përmendet numri i prokurimit, siç është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit, e ku një kërkesë e tillë ka qenë kërkesë obligative. Prandaj, dokumenti i bashkangjitur nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktues dhe nuk mund të konsiderohet si dëshmi që e plotëson këtë kriter të kualifikimit.

Për më tepër, **konfirmimi bankar është lëshuar më datë 01.09.2025, ndërsa hapja e ofertave është bërë më datë 15.09.2025.** Si rrjedhojë, ky dokument dëshmon vetëm gjendjen e llogarisë në datën 01.09.2025 dhe nuk dëshmon/provon se operatori ekonomik i ka pasur në dispozicion mjetet financiare në momentin e dorëzimit të ofertës apo në datën e hapjes së ofertave, respektivisht më 15.09.2025. Prandaj përveç faktit që ky konfirmim nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit i njëjti nuk ofron siguri se kërkesa për posedimin e kapitalit financiar të mjaftueshëm ishte e përmbushur në periudhën e procedurës së prokurimit (datën e dorëzimit të ofertës).

➤ Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit ka përcaktuar qartë kërkesat kualifikuese dhe dëshmitë dokumentare që operatorët ekonomik kanë qenë të obliguar t'i paraqesin, si më poshtë:

Kërkesa 3: Certifikata profesionale ISO 14001.

Evidenca 3: Certifikata duhet të jetë valide – kopje e noterizuar.

Kërkesa 4: Certifikata profesionale ISO 45001.

Evidenca 4: Certifikata duhet të jetë valide – kopje e noterizuar.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga OE i rekomanduar, rezulton se në vend të certifikatave valide ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 të lëshuara nga një organ certifikues i akredituar, ai ka paraqitur dokumente të lëshuara nga platforma Alison, të cilat në pamje të parë paraqiten si certifikata, mirëpo në të vërtetë nuk përbëjnë certifikata të sistemeve të menaxhimit ISO.

Kjo vërtetohet lehtësisht duke skanuar QR Code (Scan Code) të vendosur në certifikatë. Pas skanimit, hapet faqja zyrtare e Alison me titull "Your Learner Verification", ku shprehimisht thuhet:

"This is to verify that NNP 'CTA' SHPK has completed the course ISO 14001:2015 – Environmental Management Systems (EMS)", përkatësisht për certifikatën tjetër: "has completed the course ISO 45001:2018 – Principles of Occupational Health and Safety Management Systems."

Pra, vetë verifikimi zyrtar i Alison konfirmon se dokumenti nuk dëshmon se operatori ekonomik është i certifikuar sipas standardeve ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, por vetëm se ka përfunduar një kurs online lidhur me këto standarde.

Madje, në faqen e verifikimit për ISO 45001:2018 figuron edhe:

Course Completed (Kursi i përfunduar);

Final Assessment Score – 93% (Rezultati i testimit);

Total Study Time – 0h 10m (Koha totale e studimit).

Ndërsa për ISO 14001:2015 figuron:

Course Completed (Kursi i përfunduar);

Final Assessment Score – 92% (Rezultati i testimit);

Total Study Time – 0h 21m (Koha totale e studimit).

Këto të dhëna tregojnë qartë se bëhet fjalë për një trajnim online dhe testim, e jo për një certifikim të sistemit të menaxhimit sipas standardeve ISO.

Për rrjedhojë, dokumentet e dorëzuara nga OE nuk janë certifikata valide ISO, siç është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit, por vetëm certifikata të përfundimit të një kursi online. Si të tilla, ato nuk përmbushin Kërkesën 3 dhe Kërkesën 4, përkatësisht Evidencën 3 dhe Evidencën 4, të cilat kërkojnë paraqitjen e certifikatave valide.

Për më tepër, certifikatat e paraqitura nga OE nuk kanë afat vlefshmërie apo datë skadimi, pasi ato janë vetëm certifikata të përfundimit të një kursi online. Ndërsa, dosja e tenderit ka kërkuar shprehimisht **certifikata valide**, të cilat nënkuptojnë certifikata të sistemeve të menaxhimit të lëshuara nga organe certifikuese të akredituara, me status të vlefshëm në momentin e ofertimit. Për rrjedhojë, dokumentet e paraqitura nuk e përmbushin këtë kërkesë.

Pranimi i këtyre dokumenteve nga AK-ja përbën vlerësim në kundërshtim me kërkesat e DT dhe me parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik, pasi një certifikatë e përfundimit të një kursi nuk mund të barazohet me një certifikatë valide ISO të lëshuar nga një organ certifikues i akredituar pas auditimit të sistemit të menaxhimit të operatorit ekonomik. Për këtë arsye, oferta e OE të rekomanduar është dashur të shpallet e papërgjegjshme, për shkak të mosplotësimit të këtij kriteri kualifikues.

➤ OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar: *"Baza për prodhimin e betonit e licencuar, në pronësi apo marrëveshje për furnizim me beton me një O.E. të licencuar. Prodhuesi i betonit duhet të posedojë certifikatën ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015 për prodhimin e betonit."*

OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar këtë kërkesë, pasi në vend të një marrëveshjeje për furnizim me beton, ka dorëzuar një dokument të titulluar *"Marrëveshje Qiramarrje për Makineri"*, objekt i së cilës është dhënia me qira e makinerive. Edhe pse në këtë marrëveshje është përfshirë teksti i kërkesës së DT-së lidhur me bazën e betonit dhe certifikatat ISO, askund në marrëveshje nuk specifikohet se ajo është lidhur si marrëveshje për furnizim me beton, siç ka qenë kërkesa e AK-së. Për dallim nga dokumentet e tjera të paraqitura nga vetë OE, si "Kontrata për Furnizim me Zhavorr", ku qartë specifikohet se kontrata është lidhur për furnizimin me zhavorr, në këtë rast nuk ekziston asnjë përcaktim decidiv se marrëveshja ka për objekt furnizimin me beton.

Prandaj dokumenti i paraqitur me ofertë nuk mund të konsiderohet marrëveshje për furnizim me beton, sipas kërkesës së dosjes së tenderit, pasi përmbajtja e tij nuk pasqyron një marrëveshje të tillë, por vetëm një marrëveshje për qiramarrje të makinerive, prandaj si përfundim i njëjti OE është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit.

➤ Tek kapaciteti teknik dhe profesional po ashtu është kërkuar "1.2) *Udheheqes i punimeve, duhet te jete inxhinier i diplomuar i arkitektures - 5vite pervoj pune pas diplomimit I qertifikuar per efqienc te energjise .I licensuar*", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "1.2) *Udheheqes i punimeve, duhet te jete inxhinier i diplomuar i arkitektures- 5 vite pervoj pune pas diplomimit, te deshmohe me -Diploma - kopje e noterizuar, -Kontrata e punes, nese inxhinjeri eshte ne liste te pagave ne 6 muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate te deshmohe me liste te pagave, CV e nenshkruar nga vet personi (në rast të angazhimit për këtë projekt, kontrata e udheheqesit te punimeve me ofertuesin duhet të jetë e noterizuar dhe e nënshkruar nga të dy palet). -Leter reference nga punedhenesit ose cfaredo dokumenti tjeter qe deshmon per punet dhe pervojen e meparshme inxhinierike ne lemire e caktuar. -Vendimi per udheheqes te punimeve*".

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar z. Driton Muriqi në cilësinë e udhëheqësit të punimeve. Megjithatë, nga dokumentacioni i dorëzuar për të njëjtin rezulton se referencat e

paraqitura për të njëjtin kanë të bëjnë me projekte të projektimit, e jo me udhëheqjen ose realizimin e punimeve ndërtimore.

Duke qenë se natyra e këtij aktiviteti të prokurimit është "Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës dhe Parkut", përvoja e kërkuar duhet të lidhet me realizimin dhe udhëheqjen e punimeve ndërtimore, ndërsa referencat për projektim nuk dëshmojnë përvojë në këtë fushë. Projektimi dhe ndërtimi janë aktivitete profesionale të ndryshme, me përgjegjësi dhe kompetenca të ndryshme, prandaj referencat për projektim nuk mund të konsiderohen si dëshmi e përvojës së kërkuar për pozitën e udhëheqësit të punimeve.

Për rrjedhojë, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar se personi i propozuar i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me përvojën e mëparshme inxhinierike në lëminë e kërkuar për këtë pozitë.

➤ Në dosje të tenderit është kërkuar "Kërkesa 3. Vlersimi I riskut nga nje kompani e Licensuar nga MPMS", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Deshmia 3. Operatori Ekonomik (në rast të Grupit të Operatoreve Ekonomik - Lideri) duhet të dëshmoj përmes një raporti, vlerësimin e riskut për të gjitha vendet e punës të kërkuara nga një kompani e licencuar nga AKK".

Nga analiza e raportit të vlerësimit të riskut të dorëzuar nga OE i rekomanduar rezulton se mungon vlerësimi i riskut për pozitën e **mjeshtrit dhe punëtorit fizik**, ndonëse këto pozita janë pjesë e stafit të kërkuar për realizimin e kontratës.

Prandaj OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar raport të vlerësimit të riskut për të gjitha vendet e punës të kërkuara, siç është kërkuar shprehimisht në dosjen e tenderit. Si pasojë, nuk është përmbushur kjo kërkesë kualifikuese dhe AK-ja nuk është dashur ta rekomandojë për kontratë një OE të tillë.

➤ Në dosje të tenderit po ashtu është kërkuar "Kërkesa 5. Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit: **5.14. Se paku një auto kran me kapacitet bartës min. 10 tonë**", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "Deshmia 5. Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Pajisjet nga pika 3.1 deri 3.11 duhet të dëshmojnë me librezën e regjistrimit valide dhe me foto, ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre dudinë doganorë ose faturën me transaksion bankarë mbi shitblerje nëse është ndërruar titullari i mjetit, të cilat janë kërkuar për realizimin e këtij projekti) Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet të ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët".

Kur analizohet dokumentacioni i ofruar për auto kranin, shihet qartë se askund nuk është prezantuar ndonjë dokument që tregon që i njëjti auto kran e posedon kapacitetin bartës min.10 ton.

Në mungesë të një dokumenti që dëshmon karakteristikat teknike të auto kranit, autoriteti kontraktues nuk ka pasur bazë objektive për të konstatuar se pajisja e ofruar i përmbush specifikimet minimale të kërkuara, përkatësisht kapacitetin bartës prej minimum 10 tonësh. Prandaj OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kësaj kërkesë kualifikuese, ndërsa pranimi i një pajisjeje pa dëshmi për karakteristikat teknike të kërkuara është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

➤ OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se të njëjtëve ju mungojnë fotografitë për disa prej pajisjeve si kontejnerët, makinat e suvatimit dhe estrihut, ndërsa në dosje të tenderit është specifikuar saktë që duhet të ofrohen edhe fotografitë për pajisjet e ofruara.

➤ Autoriteti kontraktues, nga data e dorëzimit të ofertave deri në njoftimin mbi vendimin për dhënie të kontratës, ka kërkuar disa herë vazhdimin e vlefshmërisë së sigurimit të tenderit. Me kërkesën tonë për qasje në dokumente, kemi kërkuar edhe të gjitha vazhdimet e sigurimit të tenderit të operatorit ekonomik të rekomanduar. Megjithatë, autoriteti kontraktues na ka ofruar vetëm sigurimin e dorëzuar me ofertë dhe sigurimin e fundit të vazhduar, ndërsa nuk ka ofruar vazhdimet e tjera.

Kjo krijon dyshim të bazuar se operatori ekonomik i rekomanduar mund të ketë pasur ndërprerje në vlefshmërinë e sigurimit të tenderit. Nëse nuk do të kishte pasur ndërprerje, autoriteti kontraktues nuk do të kishte arsye të mos i ofronte të gjitha vazhdimet e sigurimit.

Prandaj, kërkojmë nga eksperti shqyrtues ti analizoj të gjitha vazhdimet e sigurimit të tenderit, me qëllim të verifikimit të vazhdimësisë së vlefshmërisë së tij për OE e rekomanduar për kontratë gjatë gjithë procedurës së prokurimit.

Ne me dt. 05.08.2026 kemi pranuar nga AK-ja vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me arsyetimin se e njëjta është e pabazuar, vendim ky me të cilin ne nuk pajtohemi pasi që AK-ja nuk ka dhënë fare përgjigje në pretendimin tonë ankimor.

-Në lidhje me arsyen e parë të eliminimit, AK-së është përgjigjur si më poshtë:
OE ankues ka propozuar z. **Arbër Berisha**, i cili, sipas dokumentacionit të paraqitur, është inxhinier i arkitekturës. Licenca për **Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis – VNM** nuk e zëvendëson diplomën Bachelor ose Master në Mbrojtjen e Ambientit, e cila ka qenë kërkesë e qartë dhe e detyrueshme e Dosjes së Tenderit.

Kualifikimi akademik dhe licenca profesionale janë dokumente me natyrë dhe qëllim të ndryshëm. Licenca VNM mund të dëshmojë autorizim për ushtrimin e veprimtarive të caktuara, por nuk dëshmon se personi posedon drejtimin akademik të kërkuar nga AK-ja.

AK-ja nuk mund ta zëvendësojë pas hapjes së ofertave kualifikimin e kërkuar me një kualifikim tjetër, pasi kjo do të përbënte ndryshim të kriterit dhe trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Sa i përket drejtimit akademik të përmendur nga AK-së, sqarojmë se ky tender ka të bëjë me ndërtim e jo me mbajtje të ligjëratave, prandaj e rëndësishme është në këtë rast posedimi i njohurive dhe përvoja në këtë fushë e inxhinierit të kontestuar e jo grada.

-Në lidhje me arsyen e dytë të eliminimit, AK-së është përgjigjur si më poshtë:

Sipas Dëshmisë 5, marrëveshja për marrjen me qira të pajisjeve është dashur të jetë në emër të projektit, e vlefshme gjatë kohëzgjatjes së kontratës, si dhe e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët.

Dokumenti i dorëzuar me ofertë nuk ka qenë i nënshkruar dhe as i vulosur, ndërsa ka përmbajtur datën **12.10.2025**, pra datë pas afatit të dorëzimit të ofertave. Si rrjedhojë, në momentin relevant të vlerësimit nuk është dëshmuar ekzistenca e një marrëveshjeje valide dhe as disponueshmëria e mjeteve të kompanisë “Loni” SH.P.K.

Pretendimi se gabimisht është ngarkuar një version tjetër nuk e ndryshon gjendjen dokumentare të ofertës. Një marrëveshje tjetër, e nënshkruar dhe e vulosur, e paraqitur pas afatit, nuk do të përbënte vetëm sqarim të dokumentit ekzistues, por zëvendësim të një dëshmie të paplotë me një dokument të ri, duke ndryshuar gjendjen materiale të ofertës.

Neni 59.2 i LPP-së përcakton se AK-ja mund të kërkojë sqarime, por nuk lejon që përmes sqarimit të kërkohej ose të pranohet ndryshim material i tenderit. Po ashtu, neni 59.4 lejon vetëm korrigjimin e gabimeve ose paqartësive që nuk ndryshojnë kushtin material të ofertës.

Edhe mundësia e paraparë në nenin 72 për plotësimin ose qartësimin e dokumenteve nuk mund të përdoret për të krijuar pas afatit një dëshmi që nuk ka qenë e rregullt në ofertën fillestare.

Prandaj, mungesa e nënshkrimeve dhe vulave, si dhe data e marrëveshjes pas afatit të dorëzimit, përbëjnë mangësi materiale dhe jo devijim të vogël. Rrjedhimisht, arsyetja e eliminimit mbetet e bazuar dhe pretendimi i OE ankues refuzohet si i pabazuar.

Lëshimi teknik gjatë ngritjes së ofertës në E prokurim nuk përbën ndryshim material të tenderit, prandaj kërkesën për sqarim e përcakton qartë edhe neni 72 par.1 i LPP-së, ku ceket që *“Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës”*.

Mbi këtë bazë ligjore është dashur të kërkohej sqarime ose më pastaj është dashur të merret parasysh dokumenti i bashkangjitur me kërkesë për rishqyrtim, sepse lejohet të merren parasysh dokumentet specifike dhe ato kur janë jo të plota ose të gabuara.

-Në lidhje me pretendimin tonë ankimor për deklaratën nga Banka të OE të rekomanduar për kontratë, AK-së përdor standard tjetër të arsytimit në raport me këtë OE, pasi që në këtë rast thirret në përmbajtjen e dokumentit, ndërsa e konsideron të parëndësishme faktin që deklarata e bankës nuk përmban titullin dhe numrin e aktivitetit të prokurimit.

Pra, AK-së shmanget nga kërkesa e dosjes së tenderit në raport me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa në raport me ofertën e tonë vepron ndryshe duke vlerësuar çdo kërkesë strikt.

-Në lidhje me pretendimin ankimor se OE nuk ka prezantuar marrëveshja për beton, AK-së është munduar të arsyetohet se nuk ka rëndësi titulli i marrëveshjes, mirëpo ky arsyetim nuk qëndron dhe nuk argumenton të kundërtën e pretendimit tonë ankimor.

Për OE të rekomanduar për kontratë, AK-së e zbulon dhe interpreton edhe qëllimin e marrëveshjes sipas dëshirës së tyre vetëm e vetëm që ta favorizojë atë OE.

Fakti se marrëveshjes së qiramarrjes për makineri i është bashkëngjitur edhe leja valide e KPPP-së dhe certifikatat ISO, nuk mund të interpretohet që kjo marrëveshje është për furnizim me beton. I njëjti OE ka bashkangjitur një marrëveshje për furnizim me zhavorr, dhe kjo është në rregull dhe mund të merret parasysh, ndërsa të quhet marrëveshje e qiramarrjes së makinerive, marrëveshja për furnizim me beton është absurditet i llojit të vet dhe është më tepër se favorizim i hapur i OE

të rekomanduar për kontratë. Duhet sqaruar se përveç titullit në marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve, askund nuk figuron që palët lidhin marrëveshje për furnizim me beton apo ndonjë gjë të tillë, por në marrëveshje është vendosur vetëm kërkesa e dosjes së tenderit, pra marrëveshja për qiramarrje të pajisjeve në asnjë mënyrë nuk mund të cilësohet si marrëveshje për furnizim me beton.

-Në lidhje me pretendimin ankimor se z. Driton Muriqi referencat ika në lëmi të tjera e jo në atë që është kërkuar, inxhinierike, AK-së është përgjigj si në vijim:

Dosja e Tenderit ka kërkuar që udhëheqësi i punimeve të jetë inxhinier i diplomuar i arkitekturës, me së paku pesë vjet përvojë pas diplomimit, i licencuar dhe i certifikuar për efikasitet të energjisë. Përvoja është lejuar të dëshmohet me letër reference nga punëdhënësi ose me çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon punët dhe përvojën e mëparshme inxhinierike në lëmin përkatës. Nuk është kërkuar që referencat të mbajnë domosdoshmërisht titullin "udhëheqës i punimeve".

Për z. Driton Muriqi janë dorëzuar diploma e arkitekturës, Licenca A nr. A-0190, certifikata për efikasitet të energjisë, CV-ja e nënshkruar dhe vendimi për caktimin e tij si udhëheqës i punimeve. Në CV evidentohet përvojë si "Supervisor Architect", me detyra në mbikëqyrjen dhe planifikimin e punimeve ndërtimore, ndër të tjera te DIJAR-CO gjatë periudhës 2008–2015 dhe te ALBI GROUP nga viti 2021.

Prandaj, nuk qëndron pretendimi se përvoja e tij lidhet vetëm me projektimin. Dokumentacioni, i vlerësuar në tërësi, dëshmon më shumë se pesë vjet përvojë pas diplomimit në fushën e arkitekturës, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen dhe planifikimin e realizimit të punimeve.

Rrjedhimisht, z. Driton Muriqi i plotëson kërkesat e përcaktuara për pozitën e udhëheqësit të punimeve dhe pretendimi i OE ankues refuzohet si i pabazuar.

Përgjigja e AK-së nuk përkon me pretendimin tonë ankimor dhe për më tepër është shmangie nga pretendimi i drejtpërdrejtë. Nga dokumentacioni i dorëzuar për të njëjtin rezultat se referencat e paraqitura për të njëjtin inxhinier kanë të bëjnë me projekte të projektimit, e jo me udhëheqjen ose realizimin e punimeve ndërtimore.

-Sa i përket vlerësimit të riskut të OE të rekomanduar për kontratë, AK-së është përgjigj si më poshtë:

Dosja e Tenderit ka kërkuar që OE të paraqesë raport të vlerësimit të riskut për të gjitha vendet e punës të kërkuara, të hartuar nga një kompani e licencuar.

OE i rekomanduar ka dorëzuar raportin e hartuar nga B&M SH.P.K., kompani e licencuar për shërbime të sigurisë dhe shëndetit në punë. Raporti është lëshuar më 09.07.2025, është i vlefshëm deri më 09.07.2027 dhe përfshin gjithsej 19 pozita pune.

Në raport janë përfshirë pozitat profesionale dhe operative të kërkuara, përfshirë inxhinierët, teknikët, manipuluesin e makinerisë, armiruesin, suvatuesin, skelistin, muratorin dhe instaluesin elektrik. Pozitat e përgjithshme "mjeshtër" dhe "punëtor fizik" nuk janë përcaktuar si vende të veçanta pune në kërkesën e Dosjes së Tenderit.

Prandaj, OE i rekomanduar ka dorëzuar vlerësimin e riskut për 19 pozitat e kërkuara dhe pretendimi i OE ankues refuzohet si i pabazuar.

Nga kjo përgjigje kuptohet se edhe vetë AK-së e ka pranuar se raporti i vlerësimit të riskut të OE të rekomanduar për kontratë nuk është i kompletuar, siç është kërkuar në dosje të tenderit, ndërsa arsyetimi se pozitat mjeshtër dhe punëtor fizik nuk janë përcaktuar si vende të veçanta pune është arsyetim absurd pasi që edhe këto pozita janë pozita të punës dhe është dashur të përfshihen në vlerësim të riskut.

-Në lidhje me pretendimin ankimor se nuk është dëshmuar që auto kranit e posedon kapacitetin bartës min.10 ton, AK-së është përgjigjur si më poshtë:

OE i rekomanduar ka dorëzuar marrëveshjen e nënshkruar me N.P.T. "Art-Com", në të cilën është përcaktuar shprehimisht vënia në dispozicion e një **auto-kranit me kapacitet bartës minimum 10 tonë**. Marrëveshja është lidhur për projektin konkret dhe është e vlefshme deri në përfundimin e tij.

Dokumentacionit i janë bashkëngjitur edhe dokumenti unik doganor dhe fotografia e pajisjes. Dokumenti doganor e identifikon pajisjen si **auto-vinç vetëlëvizës, Delmach DC 250**, me peshë bruto **27,000 kg**, duke konfirmuar ekzistencën dhe pronësinë e pajisjes konkrete të vënë në dispozicion.

Komisioni vlerësues ka bërë vlerësimin e dokumentacionit në tërësi, duke marrë për bazë:

- specifikimin e kapacitetit minimum 10 tonë në marrëveshjen e nënshkruar;
- identifikimin e pajisjes në dokumentin doganor;
- peshën bruto dhe karakteristikat e përgjithshme të evidentuara në dokument;
- fotografinë e pajisjes.

Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar katalog teknik, fletë teknike apo certifikatë të prodhuesit për dëshmimin e kapacitetit ngritës. Për pajisjet pas pikës 5.11 është kërkuar dokumenti i pronësisë ose marrëveshja për marrje me qira, kërkesë e cila është përmbushur.

Prandaj, komisioni nuk e ka bazuar vlerësimin vetëm në peshën bruto, por në tërësinë e dokumenteve të dorëzuara, ndërsa kapaciteti minimum prej 10 tonësh është deklaruar shprehimisht në marrëveshjen e nënshkruar nga të dyja palët. Rrjedhimisht, pretendimi refuzohet si i pabazuar.

Konstatimi i AK-së se është bazuar në marrëveshjen e nënshkruar ku ceket kapaciteti prej 10 tonësh është dëshmi e qartë se vetë AK-së e ka pranuar se nuk është dëshmuar me fakte konkrete pesha e auto kranit, pasi që në marrëveshja mund të shënohen çfarëdo e dhënë mirëpo tonazha duhet dëshmuar me dokumente të tjera që janë të lëshuara nga organet kompetente e jo të dëshmohet me dokumente që përgatitin OE.

Autoriteti kontraktues nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve tona ankimore se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se të njëjtëve ju mungojnë fotografitë për disa prej pajisjeve si kontejnerët, makinat e suvatimit dhe estrihut dhe pretendimin se dokumentet e dorëzuara nga OE nuk janë certifikata valide ISO, siç është kërkuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit, por vetëm certifikata të përfundimit të një kursi online. Si të tilla, ato nuk përmbushin Kërkesën 3 dhe Kërkesën 4, përkatësisht Evidencën 3 dhe Evidencën 4, të cilat kërkojnë paraqitjen e certifikatave valide.

Në lidhje me pretendimin tonë sa i përket vazhdimëve të sigurimeve të tenderit, AK-ja është arsyetuar si në vijim:

Vazhdimet e sigurimit të tenderit janë bërë me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, në kuadër të kërkesave për zgjatjen e validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit, dhe janë ngarkuar nga OE i rekomanduar në platformën E-Prokurimi. Kërkesat e AK-së për zgjatje janë evidentuar përmes formularëve përkatës të datave **15.12.2025** dhe **23.02.2026**.

Sigurimi fillestar me vlefshmëri **15.09.2025–15.01.2026** ka qenë pjesë e ofertës së dorëzuar. Vazhdimi për periudhën **15.01.2026–16.05.2026** është ngarkuar në E-Prokurimi më **13.01.2026**, ndërsa vazhdimi për periudhën **16.05.2026–13.09.2026** është ngarkuar më **14.04.2026**, në të dyja rastet para skadimit të sigurimit paraprak.

Nga arsyetimi i lartcekur sqarojmë se AK-ja nuk ka arsyetuar dhe nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme se OE i rekomanduar ka pasur ofertë të vlefshme dhe sigurim të tenderit të vlefshëm në pajtim me kërkesat e nenit 28 të Rregullores Nr. 001/2022. Fakti i pranuar nga vetë AK-ja se sigurimi për periudhën **15.01.2026–16.05.2026** është ngarkuar në **E-Prokurim më 13.01.2026**,

ndërsa afati i caktuar nga AK-ja për pranimin e zgjatjes së ofertës ishte 18.12.2025, krijon detyrimin për AK-në që të dëshmojë ekzistencën e një pranimi të vlefshëm të bërë brenda këtij afati. Në mungesë të një prove të tillë, AK-ja nuk mund të mjaftohet vetëm me datën e ngarkimit të sigurimit më 13.01.2026 për të konstatuar se oferta ka pasur vlefshmëri, prandaj arsyetimi i AK-së është i paqëndrueshëm.

Duke u bazuar në të lartcekurat, kuptohet qartë se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm, në kundërshtim me dispozitat ligjore të prokurimit publik.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe OE të tjerë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse nuk jemi rekomanduar për kontratë edhe pse jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.**

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë, ndërsa ne edhe i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi shpall fitues i këtij tenderi.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”*, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse ne edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit nuk jemi rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e grupit të OE **“NIL ARCHITECTS SH.P.K.& HIDRO PROJECT SH.P.K** si e bazuar,

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në

RIVLERËSIM,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesën etj. në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*